



**Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo**  
**Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution**

Prishtinë më, 15 prill 2020,

Prof. Dr Naser Ramadani, Drejtor Ekzekutiv  
Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës  
Rruga “Nëna Terezë” p.n. (Rrethi i Spitalit)  
10000 Prishtinë  
Email: [ikshpk@rks.gov.net](mailto:ikshpk@rks.gov.net)

**Ankesa nr. 250 /2020**

**Zorica Vorguçiç  
kundër**

**Ministritë së Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës**

I nderuari z. Ramadani,

Avokati i Popullit në bazë të nenit 16, paragrafit 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 23 mars 2020, e pranoi ankesën e znj. Zorica Vorguçiç (origj. Zorica Vorgučić), gazetare dhe redaktore në RTV „KiM“ nga Çagllavica, e cila ankohet për atë se Ministria e Shëndetësisë dhe Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës nëpërmjet web faqeve të tyre zyrtare nuk informojnë edhe në gjuhën serbe qytetarët dhe publikun, posaçërisht gjatë kësaj situatë emergjente për shëndetin publik për shkak të epidemisë së virusit COVID-19.

Nga ankesa e parashtruar rezulton se ankuesja ka paraqitur ankesë dhe njëkohësisht ka pasur për qëllim që t’ia tërheq vëmendjen Institucionit të Avokatit të Popullit për faktin se palët përgjegjëse po i publikojnë njoftimet e tyre publike në web faqet zyrtare vetëm në gjuhën shqipe, megjithëse përveç gjuhës shqipe edhe gjuha serbe qoftë sipas Kushtetutës,<sup>1</sup> qoftë sipas Ligjit për përdorimin e gjuhëve,<sup>2</sup> është njëra nga dy gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

Në të njëjtën ditë, pas paraqitjes së ankesës së gazetares dhe redaktore në RTV „KiM“ znj. Vorguçiç, Institucioni i Avokatit të Popullit e bëri verifikimin e pretendimit dhe iu qas web faqes zyrtare të Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik. Institucioni i Avokatit të Popullit e konstatoi që ankesa ishte e justifikuar dhe se në webfaqen e Institutit nuk ka lajme të publikuara, njoftime ose informacione me rëndësi për publikun, me të cilat informoheshin

<sup>1</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni.5, paragrafi 1.

<sup>2</sup> Ligji nr.02/L-037 për përdorimin e gjuhëve

qytetarët edhe në gjuhën serbe. Po ashtu, në webfaqen e Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik nuk ka as opsion për gjuhën serbe.<sup>3</sup>

Bazuar në ato që u thanë më sipër, Avokati i Popullit me këtë rast, ia tërheq vëmendjen Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik për obligimet e tij ligjore lidhur me respektimin e Kushtetutës dhe Ligjit për përdorimin e gjuhëve, në të cilat thuhet që gjuha shqipe dhe gjuha serbe janë gjuhë zyrtare në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, që ato janë të barabarta dhe në përdorim të barabartë në të gjitha institucionet shtetërore.<sup>4</sup>

Institucioni i Avokatit të Popullit në bazë të ankesës së pranuar, dëshmime dhe qasjes në webfaqen zyrtare të Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik, konkludon që i njëjti ka dështuar që në të dy gjuhët zyrtare ta zbatojë legjislacionin pozitiv dhe të raportojë para publikut për masat që po i ndërmerren dhe për të gjitha informacionet përkatëse që i publikon në lidhje me situatën e epidemisë COVID-19 në Republikën e Kosovës.


Avokati i Popullit në pajtim me nenin 135. paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: „ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.” dhe në pajtim me nenin 18, paragrafin 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit duhet „të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla;”

Prandaj, Avokati i Popullit i rekomandon Institutit Kombëtar për Shëndetin Publik të Republikës së Kosovës:

***Të veprojë në përputhje me dispozitat e nenit 5 paragrafit 1 të Kushtetutës dhe Ligjit nr. 02/L-037 për përdorimin e gjuhëve dhe qytetarët dhe publikun, në kohën e duhur dhe të menjëhershme përmes faqes së tij zyrtare t’i informojë në të dy gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës, në përputhje me dispozitat e lartpërmendura kushtetuese dhe ligjore.***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerreni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

  
Hilmi Jashari  
Avokat i Popullit

Kopje për: z. Slavisa Mladenović, Komisioner për gjuhë në Republikën e Kosovës

<sup>3</sup> [www.niph-rks.org](http://www.niph-rks.org) pristupljeno 25.03.2020., 26.03.2020. i 01.04.2020.

<sup>4</sup> Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 5. paragrafi 1.

Ligji nr.02/L-037 për përdorimin e gjuhëve, neni 1. paragrafi 2. dhe neni 2. (2.1 i 2.2.)